

SISTEMI POLITIK NË FRANCË

Një analizë e shkurtër mbi sistemin politik në Francë

1. Ndarje jo e pastër e pushtetit ndërmjet presidentit, kryeministrit dhe parlamentit.
2. Zgjedhjet popullore kanë një ndikim në pozitën politike të Presidentit. Legjitimiteti i zgjedhjeve popullore dhe pushteti substancial i garantuar e bëjnë presidentin figurën kryesore që nga Kushtetuta e vitit 1958.
3. Në rastet kur Presidenti nuk e ka përkrahjen e shumicës në parlament, sistemi punon si një sistem parlamentar në të cilin partia apo koalicioni partiak që ka shumicën e vendeve në parlament formon qeverinë.
4. Në rastet kur Presidenti ka shumicën në parlament ai krijon marrëdhëniet e tij me legjislativin në bazë të parimeve që ai luan rolin udhëheqës në ndërveprimet ekzekutiv-legjislativ. Kjo ka efektin e përqëndrimit të pushtetit dhe aktivitetit politik jashtë parlamentit.
5. Në modelin politik ku kryetari i shtetit ka shumicën në parlament, sistemi funksionon nën udhëheqjen e tij. Ai kryeson qeverinë de jure dhe de facto. Kryeministri i caktuar me aprovimin e parlamentit është në pozitë të pafavorshme politike, duke u detyruar të respektoj në shumicën e rasteve vullnetin politik të presidentit. Kryeministri drejton kabinetin në aspektin administrativ dhe teknik nën drejtimin e kontrrolluar të presidentit. Në modelin politik ku presidenti përballet me shumicën në parlament që e kundërshton atë, ai është i detyruar të caktojë liderin e shumicës parlamentare si kryeministër. Në këtë rast, sistemi francez funksionon në variantin parlamentar. Lidërshipi i vërtet politik nëpërmjet kabinetit zhvendoset tek Kryeministri, i cili është përgjegjës për politikën që do ndjek kabineti. Kjo praktikë e raporteve ndërmjet presidentit dhe kryeministrit, në literaturën franceze njihet si "Bashkëjetese".
6. Mungesa e një mazhorance të qëndrueshme në parlament i bën raportet ndërmjet presidentit, kabinetit dhe parlamentit më shumë të komplikuar. Kryeministri gjendet ndonjëherë në pozicionin sanduiç mes presidentit dhe parlamentit. Ai ka një vartësi të dyfishtë dhe përgjegjesi të dyfishtë para Presidentit dhe para parlamentit, përderisa emërimi i tij varet prej tyre. Kryeministri duhet të jetë më i interesuar të bashkëpunojë me parlamentin, pasi mbijetesa e tij në pozitën zyrtare varet nga besimi i këtij të fundit. Zgjedhja më e mirë për kryeministrin në përballje me një parlament të fragmentuar është të mos adoptojë politika radikale, pasi atij i duhet besimi parlamentar.

Përbërja e Parlamentit, sipas Kushtetutës së Republikës së Pestë; numri i komisioneve të përhershme (gjashtë komisione).

Gjashtë Komisionet e Përhershme të Asamblesë Kombëtare janë:

1. Komisioni për Kishën, Familjen dhe Çështjet Sociale.
2. Komisioni për Punë të Jashtme.

3. Komisioni për Mbrojtjen Kombëtare dhe Forcat e Armatosura.
4. Komisioni për Financa, Ekonomi dhe Planifikim.
5. Komisioni për të Drejtën Kushtetuese, Legjislacion dhe Administratë të Përgjithshme.
6. Komisioni për Prodhimin dhe Shkëmbimin.

Gjashtë Komisionet e Përhershme të Senatit janë:

1. Komisioni për Çështje Kulturore.
2. Komisioni për Çështjet Ekonomike dhe Planifikimin.
3. Komisioni për Punë të Jashtme, Mbrojtje dhe Forca të Armatosura.
4. Komisioni për Çështjet Sociale.
5. Komisioni për Financat, Kontrollin e Buxhetit dhe Llogaritë Ekonomike të Kombit.
6. Komisioni për ligjet kushtetuese, legjislacionin, votimin universal, procedurën dhe administratën e përgjithshme.

Përveç këtyre komisioneve të përhershme, secila Dhomë mund të caktojë disa komisione të përkohshme.

Përbërja e komisioneve:

Anëtarësia e çdo komisioni është e ndryshme. Komisioni për Çështjet Fetare, Sociale dhe Familjare ka 120 anëtarë ndërsa Komisioni për Kushtetutë, Legjislacion dhe Administratë të Përgjithshme ka vetëm 60 anëtarë. Në këto komisione, të gjitha grupet parlamentare të njohura janë dhënë përfaqësim proporcional. Çdo Komision i Përhershëm ka një President, 3 ose 4 Nënkyetar dhe 2 deri 4 Sekretarë. Për çdo projekt-ligj, secili komision zgjedh një raportues. Raportuesi vepron si kujdestar i projektligjit si në Komision dhe në Kuvend. Këto komisione mbajnë takime sekrete. Megjithatë, ministrat mund të ndjekin mbledhjet e tyre.

Funksionet dhe roli i komisioneve:

Komisionet e Përhershme janë organe shumë të fuqishme. Ata mund të thërrasin nëpunësit civilë dhe ministrat para tyre për të dhënë shpjegime dhe justifikime për masat që po diskutohen nga komisionet. Në këtë mënyrë, ata janë të ngjashëm me komisionet e përhershme të Kongresit Amerikan.

Komisionet e Përbashkëta: Për më tepër, kur Qeveria deklaron një projekt-ligj urgjent, Kryeministri mund të kërkojë nga të dyja Dhomat që ta dërgojnë projektligjin në një komision të përbashkët. Një komision i tillë përbëhet nga një numër i barabartë anëtarësh të tërhequr nga secila Dhomë. Komisioni i Përbashkët ka përgjegjësinë për të gjetur dispozita të kontestuara të mosmarrëveshjeve.

Parlamenti i Francës kryen funksionet e saj ligjvënëse me ndihmën e një numri komisionesh të mirëorganizuar. Organizimi dhe funksionet e këtyre komisioneve janë mjaft të ngjashme me strukturën dhe funksionet e sistemit të komitetit.

Karakteristikat dalluese të sistemit gjysëm presidencial në Francë në dallim nga sistemi presidencial në SHBA

1. SHBA është një federatë shtetesh me një sistem të pastër presidencial.
2. Franca është sistem gjysëm presidencial; shtet unitar i centralizuar.
3. Në SHBA Presidenti është kryetari i shtetit dhe i qeverisë. Nuk kemi kryeministër dhe presidenti e ushtron tërësisht pushtetin ekzekutiv. Mandati i tij është 4 vjetar me të drejtën deri në dy mandate.
4. Në Francë pushteti ekzekutiv është bicefal. Presidenti i Republikës kryeson këshillin e Ministrave (neni 9 i Kushtetutës). Mandati i Presidentit është 5 vjetar me të drejtën për të kërkuar një mandat të dytë. Ai zgjidhet me votim të përgjithshëm (neni 6 i Kushtetutës).
5. Në SHBA kemi ndarje dhe ekuilibër ndërmjet të tre pushteteve "Check and Balances". Të tre pushtetet janë të pavarura dhe përmes instrumenteve të caktuara kufizojnë njëra tjetrën në mënyrë reciproke. Kongresi nuk mund ta shkarkojë qeverinë apo presidentin, përveç rasteve kur ndaj tij aplikohet procedura impeachment.
6. Në Francë, kur kushtetuta shkelet nga ana e presidentit të republikës, Asambleja Kombëtare mund ta akuzojë presidentin para Këshillit Kushtetues, i cili mundet edhe ta shkarkojë presidentin. Padinë për përgjegjësi penale ndaj presidentit e ngre Gjykata e Kasacionit, ndërsa gjykimi i tij bëhet nga Gjykata e Lartë e Drejtësisë.
7. Në SHBA presidenti nuk mundet në mënyrë direkte të ndikojë në nxjerrjen e ligjeve nga Kongresi. Ndikimi i tij është indirekte përmes mesazheve që ai drejton përmes agjensive federale.
8. Presidenti amerikan nuk mund ta shpërndaj Kongresin, siç mund të ketë të drejtë presidenti francez. Në anën tjetër as Kongresi nuk ka të drejtë ta rrëzojë qeverinë, siç kemi rastin në Francë ku dhoma e ulët e parlamentit francez apo Asambleja Nacionale mund ta rrëzojë Qeverinë në rastet e caktuara kur përdor votën e mosbesimit ndaj saj.
9. Presidenti i Republikës në Francë mund të deklarojë shpërndarjen e Asamblesë Kombëtare (sipas neni 12 të Kushtetutës).
10. Presidenti i SHBA-së për dallim nga ai i Republikës së Francës e ka të drejtën e përdorimit edhe të vetos ndaj ligjeve të Kongresit.
11. Në Francë presidenti mund të shkarkoj anëtarët e qeverisë vetëm me propozim të kryeministrit. Presidenti nuk ka të drejtën e shkarkimit të kryeministrit dhe kabinetit pa miratimin e Parlamentit.
12. Në Francë qeveria nuk përgjigjet para presidentit por vetëm para Asamblesë Nacionale.
13. Presidenti i SHBA-së së bashku me Senatin ka të drejtën të emërojë gjyqtarët e Gjykatës Supreme.
14. Presidenti francez ka të drejtën të emërojë tre antarë të Këshillit Kushtetues dhe kryetarin e saj. Në Francë është karakteristikë që çdo ish-president francez ka të drejtën për të qenë anëtar i Këshillit Kushtetues.
15. Franca ka sistem shumëpartiak, ku si në zgjedhjet parlamentare ashtu edhe në ato presidenciale aplikohet sistemi dyraundësh. Mirëpo, në zgjedhjet parlamentare nuk kemi

garë eliminimi. Në raundin e parë partitë që e kalojnë pragun electoral 12.5 përqind garojnë në raundin e dytë, ku në këtë raund nuk kërkohet shumica absolute por shikohet se kush fiton më së shumti vota. Sipas këtij sistemi zgjedhor Presidenti zgjidhet direkt nga populli ku në raundin e parë kërkohet shumica absolute ndërsa nëse nuk arrihet kjo shumicë pason raundi i dytë, i cili mbahet një javë apo dy më pas. Raundi i dytë është garë eliminimi mes dy kandidatëve që marrin më së shumti vota nga raundi i parë. Pas zgjedhjeve mund të krijohet një legjislaturë heterogjene dhe një qeveri koalicioni.

16. Në SHBA Dhoma e Lartë apo Senati më tepër është edhe organ këshilldhënës i presidentit. Kryetari i Senatit është nënpresidenti i SHBA-së. Dhoma e Përfaqësuesve në SHBA ka 435 përfaqësues (numri i deputetëve në Dhomen e Përfaqësuesve, që çdo shtet federal i dërgon në Kongres, vendoset nga numri i popullsisë në shtetin e caktuar). Dhoma e Përfaqësuesve përbëhet nga anëtarë që zgjidhen çdo dy vjet nga populli i shteteve të veçanta (neni 1/para.2). Senati ka 100 senatorë (përbërja dhe kompetencat e Senatit janë përcaktuar në nenin 1/para.3 të Kushtetutës). Senati përbëhet nga dy senatorë për çdo shtet, [të cilët zgjidhen nga legjislatura përkatëse,] për një periudhë gjashtë vjeçare. Çdo senator ka të drejtën e një vote.

Karakteristikat dalluese të sistemit parlamentar francez nga ai parlamentar anglez

1. Në Francë shef i shtetit është presidenti i cili është figura kryesore politike në vend. Zgjidhet drejtëpërdrejt nga populli, sipas sistemit mazhoritar dy raundësh dhe përfaqëson vullnetin e popullit.
2. Në Angli rolin e shefit të shtetit e ushtron formalisht mbretëresha. Në Angli Kurora Mbretërore nuk përfaqëson vullnetin e popullit por historinë e Anglisë.
3. Në Francë presidenti është edhe shef i ekzekutivit.
4. Në Angli këtë privilegj e gëzon Kryeministri. Ai udhëheq si politikën e brendshme dhe atë të jashtme, ku për punën e tij ai njehkohësisht informon mbretëreshën.
5. Në Francë parlamenti është i balancuar dhe heterogjen. Përbëhet nga deputetët e një numri të madh të partive politike.
6. Në Angli parlamenti është i disbalancuar dhe homogjen, ku mbi 90% përbëhet nga dy partitë e mëdha politike. Dhoma e Komunave ka më shumë kompetenca se Dhoma e Lordëve e cila ka më tepër karakter formal dhe ceremonial.
7. Deputetët e Dhomës së Lordëve zgjidhen kryesisht sipas parimit të trashigimisë, ku kemi dy lloj lordësh (trashegues dhe zgjedhës). Dhoma e Lartë e parlamentit francez (Senati) ka 348 senator.
8. Dhoma e Komunave në Angli (dhoma e ulët) ka 659 deputë të cilët zgjidhen nga populli. Asambleja Nacionale ka 577 deputetë, të cilët zgjidhen sipas sistemit dy raundësh ku pragu elektoral për partitë politike është 12.5%.
9. Dhoma e Komunave në Angli në dallim nga Asambleja Nacionale përveç që e kontrollojnë qeverinë ajo e merr në pyetje kryeministrin dy herë në javë. Të martën dhe të enjten.